



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 5, paragrafi 5.2 të Ligjit nr. 03/L-087, për ndërmarrjet publike, dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 – 391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 07.08.2018, miratoi këtë

**V E N D I M**  
**PËR SHKARKIMIN E ANËTARIT TË KOMISIONIT TË AKSIONARËVE TË**  
**NDËRMARRJES PUBLIKE BANESORE, SHA**

- I. MIRATOHET Vendimi për shkarkimin e Egzon Azemit, anëtar i Komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Banesore, SHA.
- II. Anëtar i ri i Komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Banesore, SHA, do të emërohet me një vendim tjetër, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, sipas Ligjit për ndërmarrjet publike dhe Ligjit për shoqëritë tregtare.
- III. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01-118/02-0196786/18, më 10.08.2018**

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Agim Kuleta**

